POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Nensi Dojaka fiton çmimin më prestigjoz 'Louis Vuitton' të industrisë së modës për stilistët e rinj
2 Mbesa e Albana Vokshi 'dorëhiqet' nga kompania e të ëmës me 1 punëtor e fitim 629 milionë lekë në vit, ditën e denoncimit në media
3 Zbulohen përsëri armë dhe uniforma ushtarake në veri të Kosovës, Sveçla: Uniforma britanike e amerikane, skenar ogurzi për të fajësuar dhe shtetet të tjera!
4 Vucic paralajmëron serbët në Kosovë: Do ju arrestojnë nëse keni marrë pjesë në sulmin terrorist në Zubin Potok
5 Zbulohen përsëri armë dhe uniforma ushtarake në veri të Kosovës, Sveçla: Uniforma britanike e amerikane, skenar ogurzi për të fajësuar dhe shtetet të tjera!

Kronikë

Korçë/ Kërcënoi qytetarin me armën e shërbimit, nën akuzë efektivi i Policisë Ushtarake! Nën hetim edhe pronari i lokalit, e punësoi në shkelje të ligjit

Ngjarja ditën e djeshme, shkak motivet e dobëta. Pas denoncimit policia vendore i mori nën hetim në gjendje të lirë ushtarakun 33-vjeçar dhe pronarin e lokalit, 34 vjeç. Ky i fundit e kishte punësuar në mënyrë të paligjshme, sekuestrohet edhe arma e shërbimit pistoletë

Policia e Korçës

Redaksia
3 Dhjetor, 15:45 | **Përditesimi: 3 Dhjetor, 16:17**

Share

Korçë- Efektivi i Policisë Ushtarake kërcënon me armën e shërbimit pas sherrit me motive të dobëta një klient të lokalit ku ishte punësuar në mënyrë të paligjshme.

Policia vendore ka referuar materialet për efektivin e ushtrisë dhe pronarin e lokalit në Prokurori, për hetime në gjendje të lirë.

Rezulton se pronari i subjektit e kishte punësuar në mënyrë të paligjshme si roje sigurie ushtarakun, i cili akuzohet se ka përdorur armën e shërbimit për të kërcënuar qytetarin që e denoncoi ditën e djeshme (2 Dhjetor).

LEXO EDHE:
Durrës/ Aksident në Spitallë, makina përplas këmbësoren 78-vjeçare! E plagosura dërgohet me urgjencë në spital! (VIDEO)

> *"Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit M. C., 34 vjeç dhe E. F., 33 vjeç. Procedimi penal për këta shtetas nisi pasi nga veprimet hetimore të kryera për një konflikt të ndodhur ditën e djeshme, në një lokal në Korçë, dyshohet se shtetasi E. F., 33 vjeç, me detyrë punonjës i Policisë Ushtarake, ka kanosur me armën e shërbimit, shtetasin V. B., për motive të dobëta, ndërsa shtetasi M. C., pronari i lokalit, e kishte punësuar në mënyrë të paligjshme shtetasin E. F., si punonjës sigurie në lokal", bëri me dije policia vendore për dinamikën dhe rrethanat paraprake.*

Arma e shërbimit e shtetasit E. F. u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, teksa pritet të sqarohen edhe detaje të tjera nga konflikti i ndodhur.

Materialet hetimore për çështjen i kaluan prokurorisë vendore, për veprime të mëtejshme.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: policia ushtarake | policia | hetime | pronari lokalit | Korce

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
2 Dhjetor, 20:45
Jeni dakord që prokurorët e SPAK të kenë mundësinë për një mandat tjetër?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Zyrtare/ Ernest Gjoka firmos te Skënderbeu për një vit e gjysmë, trajneri: Ekip me histori, s'i thuhet jo! Takaj: S'jemi për mbijetesë
3 Dhjetor, 13:14

Kryebashkiaku i Devollit 2 orë në SPAK, i komunikohet përfundimi i hetimeve, Duro: Do qëndroj në detyrë! Akuzohet se licencoi karburantin ndërtim pa leje
3 Dhjetor, 12:40

FOTOT/ Mali i Gramozit dhuron pamje spektakolare, turistët shijojnë 'magjinë' e dëborës
3 Dhjetor, 08:09

Tiranë/ 50-vjeçari ekzekutohet brenda lokalit 'Kështjella'! Autori i dyshuar kunati i Altin Hajrit, pronar i 'Golden'! Viktima kishte punuar si menaxher i kompleksit ku u rrëmbye Jan Prenga (EMRAT+VIDEO)
1 Dhjetor, 15:54

Gjirokastër/ Në 11 muaj 53 raste të dhunës në familje! Thyhet 'tabuja', urdhër-mbrojtjeje kërkojnë dhe burrat
Piro Nase
1 Dhjetor, 15:44

Skënderbeu mbetet pa trajner, zyrtarizohet largimi i Gvozdenovic
1 Dhjetor, 15:06

'Veri Jug' reportazh në Voskopojë! Artizania tregon 'sekretet' për qilimat e veshjet me shtiza! Turizmi elitar mes dëborës
Agim Pipa
1 Dhjetor, 14:54

VIDEOLAJM/ Dardha turistike nën petkun e bardhë, vizitorë e vendas luajnë me topa bore
1 Dhjetor, 13:24

Korça nën pushtetin e borës, rreth 4 mijë abonentë pa drita! Rruga e hapur për qarkullim për Dardhë e Voskopojë
1 Dhjetor, 09:35


VIDEOLAJM/ Nis dhe në qytet, pamje spektakolare nga flokët e dëborës në Korçë
30 Nëntor, 21:35

Turizmi i bardhë, nis sezoni i skive në Dardhë të Korçës! Lëvizja e mjeteve vetëm me goma dimërore! Reshjet e dëborës në 'Rugën e Kombit', policia apelon: Pajisuni me zinxhirë
30 Nëntor, 08:59


Aksident i trefishtë në aksin Pogradec- Korcë! Makinat përplasen me njëra-tjetrën, shkak shpejtësia dhe lagështia në rrugë
29 Nëntor, 13:44

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje